



Universiteti i Prishtinës ' Hasan Prishtina'  
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-244183

Fax: +381-38-244187

Rektori: Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu

URL:<http://www.uni-pr.edu>

Mail:[rektorati@uni-pr.edu](mailto:rektorati@uni-pr.edu)

---

---

Prishtinë, më 17 shtator 2014

---

---

**PROGRAMI I PUNËS**  
**I REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

Prof.dr. Ramadan Zejnullahu

1 tetor 2014 – 30 shtator 2016

**HYRJJE**

Që nga themelimi i tij, Universiteti i Prishtinës luajti rol kyç në zhvillimet politike në Kosovë dhe, njëkohësisht, ishte edhe viktimë e ndërhyrjeve politike. Universiteti i Prishtinës ka meritë të madhe për zhvillimin e kësaj shoqërie, por edhe nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë për gjendjen e përgjithshme në shoqëri, sepse pikërisht këtu janë shkolluar shumica dërrmuese e njerëzve që sot bëjnë politikën e këtij vendi, drejtojnë ekonominë dhe veprojnë në fushat e tjera të jetës shoqërore. Kosova është ndër të fundit në Evropë si për nga zhvillimi i burimeve njerëzore, ashtu edhe për nga zhvillimi ekonomik dhe, krahas faktorëve objektivë, ne kemi pjesën tonë të përgjegjësisë për këtë gjendje.

Situata e krijuar në fillim të vitit 2014, e cila kulmoi me dorëheqjen e rektorit dhe të një pjese të Këshillit Drejtues, ka nxitur një proces reflektimi për gjendjen në Universitet, si brenda institucionit, ashtu edhe në nivel të institucioneve të shtetit dhe në opinionin e gjerë publik. Si rezultat i këtij debati joformal, jo të planifikuar dhe jo të strukturuar, ndonjëherë edhe jo të dëshiruar, i cili e ka vënë Universitetin në qendër të vëmendjes, duket se është kuptuar një gjë – në kontekstin tonë, *Universitetit të Prishtinës duhet t'i mundësohet të veprojë jashtë ndikimeve të politikave ditore dhe interesave të veçanta të grupeve dhe individëve.*

Pesëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të Luftës ne ngecim në krahasim me vendet e Rajonit, e të mos flasim fare për vendet e zhvilluara. Rangimi i fundit ndërkombëtar Webometrics, na ka dhënë vendin 4937, ndërsa universitetet publike të kryeqyteteve të Ballkanit, përveç Tiranës, janë 2000-4500 pozicione para nesh. Ka shumë faktorë që na kanë sjellë në një pozitë tillë, aspak të volitshme për ne dhe për Kosovën, në mesin e tyre: keqmenaxhimi shumëvjeçar i institucionit, papërgjegjësia në punë, mosrespektimi i kriterëve akademike dhe profesionale, tolerimi i

shkeljeve ligjore dhe statutare, fshehja e problemeve dhe hezitimi për të diskutuar për to, krijimi i grupeve të interesit brenda Universitetit, ndërhyrjet politike, e kështu me radhë.

Në periudhën gjashtëmujore të kaluar janë bërë disa hapa të rëndësishëm në stabilizimin e gjendjes në Universitet, është shtuar transparenca, dhe, në përgjithësi janë krijuar disa parakushte që të fillojë adresimi i problemeve të shtresuara me vite, madje edhe me dekada. Tani, Universiteti ndodhet në udhëkryq: këto probleme ose duhet të adresohen në mënyrë sistematike dhe të plotë ose të vazhdojë degradimi i institucionit me pasoja të paparashikueshme për vet Universitetin dhe për shoqërinë në tërësi.

## **QËLLIMI I PROGRAMIT**

Ky program i punës bazohet në platformën që i është prezantuar Këshilli Drejtues të Universitetit në procesin e kandidimit për rektor dhe është në përputhje me dokumente strategjike relevante të Universitetit të Prishtinës, si dhe ato të aprovuara nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës. Këto dokumente janë:

1. Programi Kombëtar i Shkencës 2010-2015 (miratuar nga Kuvendi i Kosovës),
2. Plani Strategjik për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë 2011-2016 (miratuar nga MASHT),
3. Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2013-2015 (miratuar nga Këshilli Drejtues),
4. Strategjia për veprimtari kërkimore-shkencore, artistike dhe zhvillimore 2013-2016 (miratuar nga Senati),
5. Plani Aksional i Rektorit të UP (hartuar me mbështetjen e USAID në vitin 2013).

Në Statutin e Universitetit të Prishtinës, misioni i Universitetit formulohet si një varg detyrash që shtrohen para institucionit, udhëheqjes dhe personelit të tij. Pra, nga Universiteti kërkohet:

- të veprojë si qendër institucionale dhe udhëheqëse për avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës;
- të luajë rolin udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;
- të ndihmojë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
- të synojë të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësim nxënies, kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike;
- të shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efikase;
- të bashkëpunojë maksimalisht dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e arsimit të lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- t'i përshtatet standardeve evropiane;
- të integrohet plotësisht në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, në Zonën Evropiane të Kërkimeve Shkencore si dhe të ndërmarrë hapat adekuat reformues të nevojshëm për arritjen e këtij misioni.

Për fat të keq, këto detyra nuk kanë qenë gjithnjë prioritetet tona, madje nuk i kemi krijuar parakushtet e nevojshme organizative dhe kuadroviqe që t'i qasemi përmbushjes së tyre. Pikërisht, ky edhe është qëllimi i këtij programi të punës:

*Të krijohen parakushte të domosdoshme për realizimin e plotë dhe të papenguar të misionit të Universitetit, duke ndërtuar dhe funksionalizuar mekanizma që mundësojnë qeverisje dhe udhëheqje cilësore, përmirësim të mësimdhënies dhe të shërbimeve për studentë, si dhe avancim të punës kërkimore-shkencore.*

Një qëllim i tillë e definon këtë program si program stabilizimi, madje, në disa fusha, edhe të normalizimit të gjendjes. Pritet që, me të përfunduar të periudhës dyvjeçare, do të krijohen kushtet për një qasje zhvillimore dhe realizim të planeve më afatgjata që do të sigurojnë qëndrueshmërinë e institucionit akademik më të madh në Kosovë.

## **OBJEKTIVAT DHE MASAT**

Ky program i ka tetë objektiva kryesore

- 1) Rikthimi i besimit të opinionit publik në Universitetin e Prishtinës,
- 2) Sigurimi i zbatimit të kritereve akademike dhe ligjshmërisë,
- 3) Përmirësimi i menaxhimit në Universitet dhe njësi akademike,
- 4) Sigurimi i financimit stabil për Universitetin,
- 5) Përmirësimi i mësimdhënies dhe i shërbimeve për studentë,
- 6) Ndërtimi i sistemit efektiv për sigurimin e cilësisë,
- 7) Nxitja e punës kërkimore-shkencore në Universitet,
- 8) Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, i mobilitetit të personelit dhe studenteve si dhe lidhja e partneriteteve strategjike,

Për secilin objektiv janë definuar masat që çojnë në arritjen e tij, ndërkaq, për secilën masë, në vijim është dhënë përshkrimi dhe janë saktësuar afatet e realizimit.

### **Objektivi 1: Rikthimi i besimit të opinionit publik në Universitetin e Prishtinës**

Nuk ka dyshim se zhvillimet në Universitet dhe rreth Universitetit kanë lëkundur besimin që ky institucion gëzonte në opinionin publik dhe, në një masë, edhe reputacionin e tij në rajon dhe më gjerë. Për këtë arsye, prioritet është kundërvënia çdo forme të korrupsionit në Universitet, duke filluar nga korrupsioni akademik, i cili manifestohet në formë të këmbimit të favoreve, nepotizmit, anashkalimit të kritereve, deri te format më ekstreme siç janë regjistrimet e paligjshme kundrejt pagesave dhe dukuritë e shëmtuara të shitjes së notave, që i takojnë domenit të veprave penale.

E dyta, do të ndërtojmë një sistem që nxit përgjegjësinë në punë. Ne nuk mund të lejojmë që njerëzit që paguhen me orar të plotë të punojnë në dy, tri e më shumë vende të tjera, duke kaluar më shumë kohë jashtë Universiteti sesa brenda tij. Prandaj, do të shfrytëzohen të

gjitha autorizimet menaxheriale të rektorit për të mos lejuar angazhime të pakontrolluara të personelit të përhershëm jashtë UP-së. Krahas kësaj, do të ketë një sistem të përcjelljes së kryerjes së detyrave të punës, në radhë të parë të rregullsisë së mbajtjes së mësimin.

E treta, do t'i kushtohet rëndësi të veçantë transparencës. Të gjitha vendimet dhe dokumentet relevante do të publikohen ose do të jenë të qasshme për publikun e gjerë. Kështu, secili do të mund të kontestojë saktësinë e të dhënave në një raport vlerësimi me rastin e pranimit të stafit akademik, ose arsyeshmërinë e secilit vendim të organeve të Universitetit dhe të njësive akademike, ose vlerën e një punimi të doktoratës.

### **Masa 1.1.** Funkcionalizimi i mekanizmave për sigurimin e respektimit të etikës akademike

Universiteti i Prishtinës ka Kodin e Etikës, i cili obligon gjithë stafin akademik t'i respektojë parimet etike dhe të veprojë gjithmonë në interesin më të mirë të Universitetit dhe të shoqërisë. Për të siguruar respektimin e këtij Kodi dhe të standardeve të etikës akademike, do të ofrohet mbështetje e plotë për Këshillin e Etikës të themeluar nga Senati që të procedojë të gjitha rastet ku ekziston dyshimi i bazuar për shkeljen e Kodit. Menaxhmenti i ri do të ketë komunikim të rregullt me Këshillin e Etikës dhe do t'i shfrytëzojë rekomandimet e tij për procedim të mëtutjeshëm të rasteve dhe për hartimin e politikave akademike dhe procedurave që sigurojnë integritetin akademik.

**Afati:** Këshilli i Etikës do të funksionalizohet gjatë muajit tetor të vitit 2014, aktivitetet tjera janë detyrë e përhershme.

### **Masa 1.2.** Kufizimi i punësimit të personelit jashtë UP-së

Si hap e parë do të synohet kufizimi i angazhimeve të stafit në marrëdhënie të përhershme pune, jashtë Universitetit të Prishtinës, me qëllimin e vetëm që stafi të jetë në dispozicion të studentëve dhe të ketë më shumë kohë për kryerjen e detyrave të punës. Në parim, do të lejohet angazhimi në më së shumti një institucion tjetër të arsimit të lartë me gjysmë norme dhe me preferencë që ky angazhim të mos interferojë me orarin e rregullt të punës. Anëtarët e stafit që dëshirojnë të angazhohen me punë jashtë UP do të bëjnë kërkesë te rektori, përmes dekanit të Fakultetit. Secilakërkesë do të shqyrtohet veç e veç dhe do të merren vendime përkatëse. E njëjta gjë vlen për stafin administrativ. Nuk do të lejohet asnjë angazhim në mësimdhënie jashtë UP për zyrtarët e lartë publikë në UP, të përcaktuar me Ligj: rektori, prorektorët, sekretari, dekanët dhe prodekanët.

Pa asnjë shtyrje do të pezullohen të gjitha kontratat e punës, në ato raste kur stafi akademik ka edhe një kontratë tjetër në shërbimin civil, që bie ndesh me Ligjin. Të gjithë personave të tillë do t'u ofrohet mundësia ta shkëpusin kontratën e dytë, duke u kthyer në marrëdhënie të përhershme pune në Universitet brenda një afati kohor të arsyeshëm, ndërkohë që do t'u mundësohet angazhimi në procesin mësimor me honorar.

Për të siguruar një zbatim konsekuent të kësaj mase, me Këshillin Drejtues do të hartohet një politikë e punësimit që përcakton qartë të drejtat dhe obligimet e personelit të UP në raport me marrëdhënien e punës.

**Afati:** Kufizimi i angazhimeve për vitin shkollor 2014/15 – deri më 1 nëntor 2014

Hartimi i politikës së punësimit nga Këshilli Drejtues – deri më 31 janar 2015.

### **Masa 1.3.** Përcjellja e rregullsisë së mbajtjes së mësimit

Do të ndërtohet një sistem për përcjelljen e rregullsisë së mbajtjes së mësimit me të cilin do të sigurohet se stafi akademik i kryen me rregull obligimet në këtë fushë. Nuk do të tolerohet që profesorët që kanë kontratë punë me UP-në, qoftë të përhershme apo me honorar, të zëvendësohen nga asistentët, përveç në raste shumë të veçanta kur nuk ka zgjidhje tjetër. Ndërkaq, sistemi i përcjelljes do të ketë edhe implikime financiare për pagesat dhe, eventualisht, për marrjen e masave të nevojshme për të siguruar rregullsinë e mbajtjes së mësimit.

**Afati:** Sistemi do të jetë funksional deri më 1 dhjetor 2014

### **Masa 1.4.** Sigurimi i transparencës

Të gjitha vendimet e organeve të Universitetit do të publikohen pa shtyrje në web faqe, si edhe dokumentet e tjera relevante për publikun e gjerë siç janë referatet për zgjedhjen e personelit akademik, raportet vjetore të Universitetit, raportet e auditimit, etj. Po ashtu, në web faqen e UP do të publikohen të gjitha punimet e doktoratës që janë mbrojtur në 15 vjetët e fundit në UP për të vazhduar pastaj edhe me punimet e mëhershme.

Do të inkurajohen organizatat studentore dhe ato të shoqërisë civile t'i monitorojnë proceset brenda Universitetit, siç janë regjistrimi i studentëve, zgjedhja e stafit akademik, rregullsia e mbajtjes së mësimit, e të ngjashme.

Pa asnjë shtyrje dhe brenda afatit ligjor do të përmbushen të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike.

**Afati:** Punimet e doktoratës do të publikohen deri më 31 dhjetor 2014. Aktivitetet tjera janë detyrë e përhershme.

## **Objektivi 2: Sigurimi i zbatimit të kriterëve akademike dhe ligjshmërisë,**

Me zbatim të përpiktë të Ligjit, Statutit dhe rregulloreve të Universitetit do të synojmë sigurimin e respektimit të kriterëve akademike dhe të ligjshmërisë në Universitet. Me konstituimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e fundit nacionale do të vendosim komunikim me to dhe do të sigurohemi të aprovohen ndryshimet statutare që do të krijojnë kushte për një shkallë më të lartë të autonomisë së Universitetit, si dhe respektimin e ligjshmërisë dhe të standardeve akademike dhe etike. Në afat të gjatë kjo do të na mundësojë një “pavarësim” akoma më të madh nga politika dhe do ta nxisë sundimin e ligjit brenda Universitetit.

### **Masa 2.1.** Sigurimi i respektimit të kriterëve akademike

Rregullorja e re për emërimin e stafit akademik paraqet një bazë të mirë për menaxhimin e konkurseve për zgjedhjenepersonelit akademik në të ardhmen. Gjatë kësaj periudhe do të përshpejtohet puna e komisioneve për përcaktimin e listave të revistave të pranueshme sipas

fushave që janë emëruar nga Senati i UP. Këto lista duhet të freskohen kohëpaskohe, prandaj edhe duhet të ketë procedura për një sipërmarrje të tilla. Listat do të publikohen në web faqen e Universitetit, ashtu si edhe të gjitha raportet e komisioneve për vlerësimin e kandidatëve për staf akademik. Këto raporte vlerësimi do të lexohen me kujdes, në mënyrë që të sigurohemi se ofrojnë argumente të mjaftueshme për të mbështetur propozimet e komisioneve dhe për të shmangur mundësitë e vlerësimeve arbitrare ose të udhëhequra nga interesa të tjera nga ato akademike.

**Afati:** Versioni i parë i listës së revistave të pranueshme do të publikohet deri më 31 dhjetor 2014. Kriteret për freskim të listës do të definohen deri më 31 mars 2015. Aktivitetet tjera janë detyrë e përhershme.

## **Masa 2.2.** Finalizimi i ndryshimeve statutare

Do të inicohet edhe një rishikim i Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mënyrë që të eliminohen kolizionet në mes të normave të atij akti dhe të qartësohen zgjidhjet, në ato raste kur nuk janë të qarta. Do të ishte ideale sikur ky rishikim të bëhet pas amendamentimit të paralajmëruar të Ligjit për Arsimin e Lartë, por edhe nëse kjo nuk ndodhë, rishikimi duhet të bëhet për të siguruar një funksionalizim të mirëfilltë të Universitetit dhe një shkallë më të lartë të autonomisë në kuadër të legjislacionit ekzistues.

**Afati:** Versioni i ri i Statutit do të jetë i gatshëm deri më 31 janar 2015, përkatësisht 3 muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Arsimin e Lartë (nëse do të ketë amendamentim).

## **Objektivi 3: Përmirësimi i menaxhimit në Universitet dhe njësi akademike**

Raporti i auditimit për vitin 2013 përmban 18 gjetje kryesore për parregullsi që shoqërohen me 18 rekomandime për marrjenmasave, shumica prej të cilave i adresohen drejtpërdrejte rektorit dhe kanë të bëjnë me aspekte vitale të funksionimit të Universitetit: Për shembull, një gjetje bën fjalë për zbatimin e procedurave joadekuate të prokurimit, që mund të sjellë deri tek keqpërdorimet financiare; tjetra për ekzekutimenebuxhetit për investime kapitale vetëm në masën 59% që është pasojë e planifikimit jo të mirë; gjetja tjetër i adresohet pagesave të pabaza që zbatohen në Universitet e që, po ashtu, hap rrugën për keqpërdorime të mundshme. Po ashtu, raporti thekson se rekomandimet nga vitet e mëhershme nuk janë adresuar në tërësi dhe me seriozitetin e duhur. Kësaj do t'i kontribuojë edhe definimi i qartë i detyrave të gjithë personelit administrativ.

Po ashtu, do të hartohen rregullore për menaxhimin e procedurave të ndryshme në Universitet, aty ku mungojnë. Në fund të mandatit, Universiteti do t'i ketë të gjitha rregulloret që parashihen me Statut dhe janë të nevojshme për të siguruar funksionimin normal dhe transparent të institucionit.

## **Masa 3.1.** Reflektimi për raportin e auditimit

Për secilën gjetje të raportit të auditimit do të reflektohet në bashkëpunim me sektorin përkatës të administratës dhe do të hartohet një plan për zbatimin e rekomandimeve. Po ashtu do të inicohet procedura ndaj të gjithë atyre që me veprimin ose mosveprimin e vet kanë bërë të mundur kryerjen e shkeljeve në procedurat financiare ose ato të prokurimit. Me zbatimin e

rekomandimeve do të synohet që në auditimin e vitit 2015 të mos ketë gjetje për shkelje ligjore që dëmtojnë prestigjin e Universitetit.

**Afati:** Deri në fund të vitit 2014.

### **Masa 3.2.** Rishikimi i organigramit të Administratës së Universitetit

Me kompletimin e ekipit menaxhues do të ngrihet një grup pune për rishikiminorganigramit të Administratës së Universitetit. Qëllimi është të definohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës dhe të ndërtohet një strukturë organizative efikase, e cila mundëson funksionimin efektiv të Universitetit. Nuk është qëllimi i këtij rishikimi shuarja e vendeve të punës, por sistemimi i punonjësve në atë mënyrë që Universiteti të jetë në gjendje të ofrojë shërbime sa më cilësore për studentë.

**Afati:** Deri më 31 mars 2015

### **Masa 3.3.** Hartimi i rregulloreve dhe politikave të nevojshme për menaxhim efektiv

Ekipi menaxhues do të përpilojë dhe do të aprovojë një plan të punës për hartimin eakteve normative dhe të doracakëve që përcaktojnë qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave udhëheqëse dhe menaxhuese në të gjitha nivelet e organizmit, si dhe raportet në mes të njësive të ndryshme organizative.

Plani i punës duhet të përmbajë një listë të akteve normative që duhet aprovuar, me përshkrimin e shkurtër të fushës që rregullojnë, me afatet e qarta të realizimit, bartësit e detyrave dhe koston financiare të realizimit. Me rastin e hartimit të planit të punës duhet të merren parasysh prioritetet e Universitetit.

**Afati:** Plani do të hartohet deri më 31 dhjetor 2014. Ndërkaq, hartimi i rregulloreve do të procedojë sipas planit.

## **Objektivi 4: Sigurimi i financimit stabil për Universitetin**

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017, jo vetëm që nuk parasheh rritje të buxhetit për Universitetin e Prishtinës në tri vitet e ardhshme, por lë të hapur mundësinë që Universiteti të ketë vështirësi për shkak të zvogëlimit të të hyrave të brendshme. Ky zvogëlim, i cili kap vlerën prej 5 mil. EUR në vit, mund të na shkaktojë probleme që në tremujorin e fundit të këtij viti. prandaj me urgjencë do të vendoset kontakti me Qeverinë në detyrë për t'u siguruar fondet e nevojshme për këtë vit fiskal. UP ka detyrime kontigjente në lartësi prej 1.8 mil. EUR, prej të cilave 1.5 mil. EUR është borxhi ndaj Administratës Tatimore, prandaj është e domosdoshme të hartohet një plan i shlyerjes së tyre..

### **Masa 4.1.** Hartimi i planit buxhetor për vitin 2015

Për vitin 2015 ne duhet të hartojmë një plan të mirëfilltë buxhetor, si dhe të bëjmë planifikimin e numrit të studentëve në përputhje me mundësitë buxhetore që kemi, gjithnjë duke pasur parasysh se përveç kuantitetit duhet ta sigurojmë edhe kualitetin. Pastaj, duhet të nxisim sa më shumë

sigurimin e të hyrave nga veprimtaria kërkimore dhe format tjera të bashkëpunimit me ekonominë. Ndërkaq, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2016-2018 duhet të reflektojë qartë nevojat reale të Universitetit të Prishtinës, prandaj në fillim të vitit vijues duhet të angazhohemi shumë që kjo të arrihet.

### **Objektivi 5: Përmirësimi i mësimdhënies dhe i shërbimeve për studentë**

Ky Universitet jeton nga studentët, prandaj duhet t'i kushtojmë kujdes të veçantë cilësisë së mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënësve. Nuk mjafton të jemi specialistë të mirë të fushës që të jemi edhe mësimdhënës të mirë, ndërsa ajo çfarë studentët shohin tek ne është, jo ekspertiza jonë shkencore, por pikërisht aftësia për t'ua përcjellë atyre njohuritë.

Gjithashtu, nuk do të rreshtim së përmirësuar shërbimet për studentë, duke shfrytëzuar deri në maksimum teknologjinë informative.

#### **Masa 5.1. Ofrimi i mundësve për zhvillim profesional për stafin akademik**

Për ta përmirësuar mësimdhënien, duhet riaktivizuar Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie të themeluar që në vitin 2007, e cila duhet të ofrojë kurse dhe këshillime për personelin akademik. Kjo mund të realizohet në bashkëpunim me donatorët që ndihmojnë Universitetin e Prishtinës. Vlerësohet se, gjatë dy vjetëve në vijim, 300-400 mësimdhënës mund të kalojnë nëpër programe trajnimi dhe të përfitojnë nga këshillimet që do t'i ofroje Qendra.

**Afati:** Qendra do të fillojë të ofrojë shërbime në maj të vitit 2015

#### **Masa 5.2. Publikimi i dokumenteve me interes për studentë në web faqen e universitetit**

Në web faqet e Fakulteteve do të publikohen të gjitha programet mësimore, oraret mësimore dhe të provimeve. Po ashtu, do të publikohen rregullisht njoftimet relevante për studentë.

Të gjithë mësimdhënësit do të inkurajohen t'ipublikojnë materialet mësimore në web faqe për t'iu mundësuar studentëve qasje të lehtë në to. Për këtë qëllim, shërbimi i Teknologjisë Informative do t'i përcaktojë domenet e rezervuara për secilin mësimdhënës. Po ashtu, Qendra për përsosmëri në Mësimdhënie do të organizojë

**Afati:** Deri më 15 janar 2015 do të kompletohen dhe publikohen programet mësimore, si dhe do të ndahen domenet për secilin mësimdhënës.

### **Objektivi 6: Ndërtimi i sistemit efektiv për sigurimin e cilësisë**

Për momentin i kemi rreth 200 programe të ndryshme studimore dhe kemi shumë pak informacion për cilësinë e tyre. Nuk mund të jetë cilësia vetëm çështje e akreditimit, i cili bëhet një herë në 3 ose 5 vjet. Prandaj, do të zbatohen me përpikëri procedurat për sigurimin e cilësisë, duke filluar nga zhvillimi i programeve mësimore deri te mbikëqyrja e zbatimit të tyre. Në njësitë akademike dhe në Senat cilësia duhet të jetë tema qendrore e diskutimeve, ndërsa menaxhmenti i Universitetit dhe ato të njësive akademike duhet të merren aktivisht me këtë temë.



### **Masa 6.1.** Ndërtimi i sistemit për vlerësimin e mësimdhënies

Gjatë dy vjetëve në vijim do ta ndërtojmë një sistem të qëndrueshëm për vlerësimin e mësimdhënies dhe për dhënien e informatës kthyesë atyre që vlerësohen. Kështu, do të krijojmë një cikël që ndërlidhë vlerësimin me planifikimin dhe do të tregojmë se i kushtojmë kujdes aspektit më të rëndësishëm të punës sonë. Do të hartohen doracakë për vlerësimin e mësimdhënies dhe do të shfrytëzohen të gjitha përparësitë e teknologjisë që kjo të realizohet në mënyrë sa më racionale.

**Afati:** Sistemi do të jetë funksional në prill të vitit 2015

### **Objektivi 7: Nxitja e punës kërkimore-shkencore në Universitet**

UP ka një strategji për veprimtarinë kërkimore-shkencore, artistike dhe zhvillimore e cila parasheh masat për periudhën 2013-2016, prandaj ne na mbetet vetëm ta zbatojmë. Me këtë rast do theksuar se puna kërkimore-shkencore është pjesë integrale e studimeve të avancuara, sidomos të atyre të nivelit të doktoratës, prandaj edhe paraqet aspekt jetik të funksionimit të institucionit. Po ashtu, pa punë kërkimore, pa bashkëpunim ndërkombëtar në këtë fushë, nuk është e mundur të përmirësohet rangimi i Universitetit.

### **Masa 7.1.** Zbatimi i privilegjeve për stafin akademik me rezultate kulminante në punën kërkimore-shkencore

Për ata që kanë rezultate kulminante në punën kërkimore-shkencore do të zbatohen privilegjet që ofron Statuti, siç është zvogëlimi i ngarkesës mësimore për deri në 1/3 e normës gjatë një viti akademik. Për ta realizuar këtë, Universiteti do të zhvillojë një rregullore, e cila do t'i përcaktojë kriteret për t'i gëzuar këto privilegje. Në bazë të kësaj rregulloreje, në përfundim të vitit akademik 2014/15 do të shpallet konkurs për stafin që dëshiron t'i shfrytëzojë këto privilegje dhe një numër i kufizuar i tyre do të mund të përfitojnë nga kjo mundësi.

**Afati:** Rregullorja do të hartohet deri në prill të vitit 2015

### **Objektivi 8: Avancimi ibashkëpunimit ndërkombëtar, i mobilitetit të personelit dhe studentëve si dhe lidhja e partneriteteve strategjike**

Universiteti, tanimë ka projekte të shumta ndërkombëtare, kryesisht të financuara nga Bashkimi Evropian, por edhe projekte të reja që na presin, si Transformational Leadership Program (TLP) që financohet nga USAID. Këto projekte të qëndrueshme. Nuk mund të tolerohet që të shpenzohen 1 milion EUR për themelimin e një programi të studimeve në një fushë atraktive dhe të kërkuar, ndërsa programi të mbyllet ditën kur përfundon projekti.

Me hapjen e programit Erasmus për vendet joanëtare të Bashkimit Evropian, ne duhet të lidhim dhe zbatojmë sa më shumë marrëveshje për këmbimin e studentëve me universitetet evropiane dhe kjo do të bëhet gjatë dy vjetëve në vijim.

### **Masa 8.1.** Hartimi i një rregulloreje për menaxhimin e projekteve ndërkombëtare

Do të hartohet një rregullore e veçantë për menaxhimin e projekteve ndërkombëtare dhe kompensimin e atyre që, me punë shtesë, kontribuojnë në realizimin e atyre projekteve. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që projektet ndërkombëtare të shihen si pjesë integrale e punës së Universitetit, e jo si ndërhyrje të kufizuara efektet e të cilave pushojnë pas përfundimit të tyre

**Afati:** Rregullorja do të hartohet deri më 31 mars 2015.

#### **Masa 5.2.** Inicohen dhe realizohen projekte të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë

Universiteti do t'i identifikojë të gjitha mundësitë për sigurimin e mbështetjes financiare për projekte të karakterit profesional ose shkencor, si nga burime vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare. Për këtë qëllim, do të mbështeten të gjitha ato ekipe brenda Universitetit që tregojnë gatishmëri për të zhvilluar projekte bashkë me partnerë dhe për t'i realizuar ato. Me këtë rast, do të shfrytëzohen skemat dhe programet ekzistuese të financimit, por edhe do të hulumtohen mundësi të tjera.

**Afati:** Detyrë e përhershme.

### **PËRFUNDIM**

Në dy vitet e ardhshme vëmendja duhet të përqendrohet në stabilizim të gjendjes dhe në ndërtimin e një baze të shëndoshë për zhvillimin e Universitetit. Vërehet se politika, pas shumë viteve, e ka krijuar një hapësirë veprimi, e cila duhet të shfrytëzohet. Nuk e kemi komfortin e mosveprimit me çfarëdo qoftë arsytimi. Përkundrazi, do të duhet ndërmarrë veprime të cilat nuk janë ndërmarrë deri tani, por janë të domosdoshme për të siguruar mbarëvajtjen e punës në Universitet. Një qasje e tillë kërkon përkushtim dhe përgjegjësi të lartë nga të gjitha organet e Universitetit dhe njësitet akademike, e cila, shpresoj se nuk do të mungojë.

Nga fundi i vitit 2015 ne do ta kemi një Strategji Afatmesme Zhvillimi të Universitetit, e cila do të mund të përqendrohet në çështjet zhvillimore e jo në ato të karakterit emergjent. Ky dokument duhet të na tregojë se si e shohim Universitetin deri në vitin 2020, çfarë duhet bërë për të tejkaluar hendekun në mes të numrit të madh të studentëve dhe numrit të vogël të personelit akademik, cilat disiplina akademike duhet t'i favorizojmë, si ta përmirësojmë infrastrukturën dhe, në përgjithësi, të sigurojmë kushte për funksionimin e papenguar të Universitetit për një periudhë më afatgjatë.